

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6754
E enjte, 10 nëntor 2022
çmimi 0.40 €

Tahiri: Shtimi i pranisë së EULEX-it rrezikon ta kthejë veriun në protektorat, FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

HYSNI GUCATI, NË GJENDJE JO TË MIRË SHËNDETËSORE, KMDLNJ KËRKON REAGIM INSTITUCIONAL FAQE 4



Gjendja shëndetësore e Hysni Gucati, i cili ndodhet në paraburgim në Hagë, është jo e mirë. Familjarët e Gucati e kanë njoftuar Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) se përkeqësimi i gjendjes shëndetësore të tij është pasojë e një intervenimi kirurgjik të komplikuar që

kishte bërë ditë më parë. KMDLNj ka kërkuar nga organizatat monitoruese ndërkombëtare që t'i ngrehin këto shqetësime, po ashtu ka kërkuar edhe nga Kuvendi i Kosovës, si themelues i Gjykatës Speciale, që nëpërmjet Komisionit për të Drejtat e Njeriut seriozisht ta trajtojë këtë shqetësim

PRICE: KOSOVA TA THEMELOJË ASOCIACIONIN, SITUATA NË VERI KA POTENCIAL TË ESKALUJË FAQE 5



HAXHIU: GJYQATARËT DHE PROKURORËT E DORËHEQUR NUK MUND TË KTHEHEN MË NË SISTEMIN E DREJTËSISË FAQE 3

AKTUALE



ENDE E PAQARTË SE KUSH DO TA KONTROLLOJË KONGRESIN AMERIKAN F. 2

MUSLIU PËR SITUATËN NË VERI: E QETË, POR ME MUNDËSI TË PËRSHKALLËZIMIT F. 3

POLICIA ARRESTON 14 PERSONA NË DISA "CALL CENTER" NË PRISHTINË F. 7

EKONOMI



GËRHXHALIU KUNDËR LIGJIT QË PËRCAKTON ÇMIMET DHE SASINË E PRODUKTEVE QË MUND TË BLIHEN F. 8

KURTI: QEVERIA ËSHTË DUKE ADRESUAR SERIOZISHT NDËRTIMIN E IMPIANTEVE PËR TRAJTIMIN E UJËRAVE F. 8

SPORT



PRISHTINA MPOSHTET NË MALISHEVË, FITOJNË DUKAGJINI DHE TREPÇA '89 F. 10

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ende e paqartë se kush do ta kontrollojë Kongresin amerikan

WASHINGTON, 9 NËNTOR - Pas zgjedhjeve të së martës në Shtetet e Bashkuara, ende nuk dihet se kush do ta ketë kontrollin e Kongresit amerikan, duke lënë të paqartë nëse republikanët do ta marrin kontrollin nga demokratët e presidentit Joe Biden.

Kongresi amerikan përbëhet nga dy institucione: Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati amerikan. Sipas "Associated Press", në Dhomën e Përfaqësuesve më së shumti ulëse kanë fituar republikanët, gjithsej 199, kundrejt demokratëve që kanë marrë 168 ulëse. Por, gara për Senatin amerikan është më e ashpër, pasi ajo mbetet ende e hapur në disa shtete kyçe.

Demokrati John Fetterman ka shpallur fitoren në Pensilvani dhe nëse ai shpallet fitues në këtë shtet, do të ishte një fitore e rëndësishme për demokratët në Senat. Sipas AP-së, me fitoren e Fettermanit demokratët deri më tani kanë fituar 48 ulëse në Senat, sa kanë edhe republikanët.

Ndërkaq, sa i përket ulëseve në senat, garat në Arizona, Xhorxhia dhe Nevada po konsiderohen se ende janë të hapura.

Gara në Xhorxhia mund të shkojë në balotazh, që do të mbahej më 6 dhjetor, dhe ky shtet mund të jetë kyç për ta përcaktuar balancën në Senat.

Sondazhet kanë treguar para zgjedhjeve se ka pasur një rënie të vlerësimit për punën e Bidenit dhe votuesit kanë qenë të zemëruar për shkak të nivelit të inflacionit.

Megjithatë, republikanët, sikurse senatori Lindsey Graham, presin që të fitojnë shumicën në Senat. "Mendoj se kur do të përfundojë gara ne do të kemi 51 apo 52 ulëse", tha ai.

Megjithatë, nëse dy partitë, ajo demokrate dhe republikane, do ta kenë numrin e njëjtë të ulëseve në Senat, atëherë demokratët do ta marrin shumicën për shkak të ulësës së nënpresidentes amerikane Kamala Harris. Edhe me një shumicë të ngushtë të republikanëve në Dhomën e Përfaqësuesve do t'u mundësonte atyre t'i bllokoni prioritetet e Bidenit.

Mbi 46 milionë amerikanë kanë votuar para ditës së zgjedhjeve, qoftë përmes postës, apo votimit në qendra të votimit. Por, zyrtarët shtetërorë zgjedhorë kanë paralajmëruar se numërimi i këtyre votave do të marrë kohë.

Inflacioni i lartë dhe të drejtat e abortit ishin ndër shqetësimet kryesore të votuesve dhe, sipas sondazheve, një në tre votues ka zgjedhur njëri prej këtyre dy temave si shqetësim kryesor. Krimi, që ka qenë në fokusin e



republikanëve gjatë javëve të fundit të fushatës, po ashtu ka qenë një prej çështjeve kryesore të përmendura nga një në dhjetë votues.

Në ShBA inflacioni vjetor është 8.2 për qind, që është niveli më i lartë i shënuar në 40 vjet. Këto shifra kanë paraqitur pengesë për demokratët gjatë fushatës së tyre. Një sondazh i realizuar nga Reuters/Ipsos gjatë kësaj jave gjeti se 39 për qind e amerikanëve

pajtoheshin me mënyrën se si ka punuar Bideni.


Ndërkaq, sipas po të njëjtit sondazh, ish-presidenti amerikan Donald Trump ka një përqindje pothuajse të njëjtë, ku 41 për qind e respondentëve e panë atë si favorit.

Në Kongres, nëse republikanët kontrollojnë Dhomën, kjo do të paraqiste kërcënim për prioritetet e demokratëve sikurse të drejtat e abortit dhe ndryshimet klimatike,

ndërkaq në Senat republikanët do të mund t'i bllokoni nominimet e Bidenit në sistemin e drejtësisë, përfshirë edhe çdo emërim të ri në Gjykatën Supreme.

Ndërkaq, sa i përket ndihmës për Ukrainën që po përballlet me pushtimin rus, analistët kanë argumentuar se nëse republikanët marrin pushtetin në Kongres, ka pak gjasa që t'i ngadalësojnë furnizimet me armë dhe ndihmën ekonomike për Kiev.

Koreja e Veriut sërish lëshon një raketë balistike



SEUL, 9 NËNTOR - Koreja e Veriut ka lëshuar një raketë balistike më 9 nëntor, ka njoftuar ushtria në Seul. Lëshimi i kësaj rakete vjen pasi më herët gjatë këtij muaji Phenjani theu rekord sa i përket numrit të raketave të lëshuara.

Lëshimi i raketës balistike erdhi teksa në Shtetet e Bashkuara po numërohen votat për zgjedhjet e mesmandatit, përkatësisht për kontrollin e Dhomës së Përfaqësuesve dhe Senatit. Më herët, agjencia e spiunazhit në Seul kishte paralajmëruar se gjatë zgjedhjeve amerikane, lideri verikorean Kim Jong Un mund të kryejë test bërthamor. Ushtria e Seulit ka njoftuar se ka "detektuar lëshimin e një rakete balistike me rreze të mesme veprimi nga Koreja e Veriut drejt Detit Lindor". Raketa, sipas Koresë së Jugut, u lëshua nga

provinca e Pionganit Jugor të Koresë së Veriut rreth orës 15:31. "Duke forcuar vëzhgimin dhe vigjilencën, ushtria e Koresë së Jugut është e përgatitur plotësisht, teksa po bashkëpunon ngushtë me Shtetet e Bashkuara", u tha në njoftimin e ushtrisë.

Japonia, po ashtu, ka konfirmuar lëshimin e raketës nga Veriu. Më herët gjatë këtij muaji, Koreja e Veriut kreu një sërë testesh, përfshirë edhe lëshimin e një rakete balistike

ndërkontinentale. Phenjani ka lëshuar një raketë balistike me rreze të gjatë veprimi, që ka kaluar kufirin de-fakto detar të Koresë së Jugut. Kjo ishte hera e parë që Koreja e Veriut lëshoi raketë në Jug që nga përfundimi i Luftës Koreane më 1953.

Tërmet i fuqishëm godet Italinë

ROMË, 9 NËNTOR - Një tërmet ka goditur bregun verilindor të Italisë në mëngjesin e së mërkurës, duke shkaktuar dëmtime në disa ndërtesa. Si

pasojë e tërmetit, personeli dhe pacientët e një klinike shëndetësore janë evakuuar. Kryeministrja italiane, Giorgia Meloni, tha se është në kontakt

me agjencinë e mbrojtjes civile të shtetit, që monitoron situatën.

Instituti i Vullkanologjisë i Italisë tha se tërmeti prej 5.7

shkallësh goditi Italinë në orën 07:07 të mëngjesit të 9 nëntorit. Epiqendra e tërmetit ishte në Ankona, në Detin Adriatik, që gjendet në rajonin Le Marche.



Haxhiu: Gjyqtarët dhe prokurorët e dorëhequr nuk mund të kthehen më në sistemin e drejtësisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Dorëheqjet e prokurorëve, të gjyqtarëve serbë dhe stafet mbështetëse të tyre në veri të Kosovës duhet të pranohen dhe të njëjtët nuk duhet të kthehen më në sistemin e drejtësisë së Kosovës, ka thënë ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu.

Në një konferencë për medie pas mbledhjes së Qeverisë së Kosovës të mbajtur të mërkurën, Haxhiu ka theksuar se Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial ende nuk i kanë trajtuar dorëheqjet e gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë, sepse

ende nuk i kanë të gjitha dorëheqjet. "Mendimi ynë është që personat që dorëhiqen nuk mund të kthehen sërish në sistem për faktin se është goditje për sistemin e drejtësisë, për Republikën e Kosovës, që një gjyqtar dhe një prokuror, të dorëhiqet për shkak të dirigjimeve që i bëhen nga Vuçiqi. Thjesht, nuk mund të them se kjo është diçka e paprecedent, sepse ka pasur bojkot edhe kur është vendosur vendimi për tarifën, po ashtu sa i përket vendimit të ndalimit të mbajtjes së zgjedhjeve apo referendumit në Kosovë. Për fat të keq, po i vuajmë pasojat e vendimeve të qeverive të kaluara. Nëse sot një gjyqtar

shqiptar dorëhiqet, natyrisht se ai nuk mund të kthehet më në sistem. Por, dorëheqjet duhet të pranohen dhe, po ashtu, të hapen konkurset për punësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj", ka thënë ministrja Haxhiu.

Të hënën, më 7 nëntor, punonjësit serbë në Gjykatën dhe Prokurorinë Themelore të Mitrovicës kanë dhënë dorëheqje në shenjë pakënaqësie ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa serbe. Përveç gjyqtarëve dhe prokurorëve, dorëheqje kanë dhënë edhe zyrtarët policorë, deputetët në Kuvendin e Kosovës nga radhët e Listës Serbe, partisë

kryesore të serbëve në Kosovë dhe një ministër në qeverinë e kryeministrit Albin Kurti.

Ministrja Haxhiu ka thënë se vetëm në ditën e parë Prokuroria dhe Gjykata e Mitrovicës janë përballur me sfida, por ka treguar se tani puna është duke vijuar normalisht. "Gjykata dhe Prokuroria në veri po funksionojnë, lëndët po trajtohen, qytetarët po i marrin shërbimet. Sfidë ka qenë dita e parë, sepse ky rast [njoftimi për dorëheqje] ka ndodhur gjatë fundjavës dhe nuk kanë qenë në dijeni për seancat që i kanë mbajtur, për vendimet për paraburgim që kanë qenë më të ndjeshme. Tashmë janë plotësuar këto vende dhe situata është duke

vijuar", është shprehur Haxhiu.

Gjyqtarët dhe prokurorët, por edhe policët serbë, u integruan në sistemin e Kosovës pasi më 2013, në Bruksel, Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për një gjë të tillë.

Përfaqësuesit e Listës Serbe kanë thënë se nuk do të kthehen në institucionet e Kosovës derisa qeveria të mos tërhiqet nga plani për targa dhe ta formojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Më 1 nëntor Qeveria e Kosovës nisi zbatimin e planit prej tri fazash për reregjistrimin e makinave me targa serbe, në ato legale RKS - Republika e Kosovës.



Musliu për situatën në veri: E qetë, por me mundësi të përshkallëzimit

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Kryetarja e Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, njëherësh deputete e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu, ka thënë se gjendja në veri të vendit është e qetë, por me mundësi të përshkallëzimit të situatës.

Musliu, pas mbledhjes së komisionit, në të cilën ka raportuar të mërkurën drejtori i AKI-së, Petrit Ajeti, në një konferencë për medie ka theksuar se institucionet e vendit janë në krye të detyrës dhe janë të gatshme për çdo provokim të mundshëm në bazë të rrethanave të krijuara. "Sot e kishim në raportim, rreth gjendjes së krijuar në veriun e Kosovës, drejtorin e Agjencisë për Inteligjencë të Kosovës (AKI), Petrit Ajeti, me të cilin diskutuam gjerë e gjerë dhe u informuam për gjendjen në veri. Sa i përket gjendjes së sigurisë mund të konstatojmë se

gjendja e sigurisë është e qetë, por gjithmonë me mundësi të përshkallëzimit.

Prandaj, institucionet e sigurisë së vendit janë në krye të detyrës dhe janë të gatshëm për çdo provokim të mundshëm në bazë të rrethanave të krijuara", ka thënë Musliu.

Ajo ka thënë se sot më shumë se kurrë duhet bashkërendim i institucioneve të vendit. "Bashkëpunim më i theksuar dhe më i madh i qytetarëve të Kosovës me institucionet e sigurisë, me theks të veçantë qytetarëve të veriut të Kosovës, për çka vlen për ta përshëndetur gatishmërinë e qytetarëve të veriut të Kosovës për të bashkëpunuar me organet e sigurisë dhe vendit në Kosovë", ka thënë Musliu, duke u bërë thirrje qytetarëve që mos të bien pre e dezinformatave të medieve serbe.

Kryetarja e këtij komisioni ka përmendur mbështetjen që ia kanë ofruar drejtorit të AKI-së në situatën e krijuar. "Si Komision për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë jemi unik



në qëndrimet tona dhe i ofruam mbështetjen e plotë drejtorit të AKI-së për situatën e krijuar në vend. Ne do të jemi të kujdesshëm të mos i lëndojmë proceset që janë duke u zhvilluar atje. Tanimë

shqetësimet i kemi të gjithë të njëjta nga terreni. Gjendja e sigurisë në veriun e Kosovës vazhdon të jetë e qetë, por duhet të jemi vigjilentë dhe të matur për të mos provokuar situatën. Deri më tani çdo gjë është

nën kontroll. Stacionet policore janë të boshatisura, mirëpo Policia e Kosovës është në krye të detyrës dhe po kujdeset për ruajtjen e rendit atje", ka thënë deputetja Musliu.



Hysni Gucati, në gjendje jo të mirë shëndetësore, KMDLNj kërkon reagim institucional

Gjendja shëndetësore e Hysni Gucati, i cili ndodhet në paraburgim në Hagë, është jo e mirë. Familjarët e Gucati e kanë njoftuar Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) se përkeqësimi i gjendjes shëndetësore të tij është pasojë e një intervenimi kirurgjik të komplikuar që kishte bërë ditë më parë. KMDLNj ka kërkuar nga organizatat monitoruese ndërkombëtare që t'i ngrehin këto shqetësime si dhe ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës, si themelues i Gjykatës Speciale, që përmes Komisionit për të Drejtat e Njeriut seriozisht ta trajtojë këtë shqetësim

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka njoftuar se gjendja shëndetësore e Hysni Gucati, i cili ndodhet në paraburgim në Hagë, nuk është e mirë dhe se përkeqësimi është pasojë e një intervenimi kirurgjik të komplikuar pas të cilit ishte edhe një intervenim tjetër kirurgjik që zgjati së paku tri orë të premtën e kaluar. "Mbrëmë, nga familjarët të Hysni Gucati, KMDLNj është informuar se gjendja shëndetësore e Hysni Gucati nuk është e mirë dhe se përkeqësimi është pasojë e një intervenimi kirurgjik të komplikuar pas të cilit ishte edhe një intervenim tjetër

kirurgjik që zgjati së paku tre orë (të premtën e kaluar) ndërsa, dje, më datë 8 nëntor 2022 ishte një intervenim më i vogël për shkakun se gjendja shëndetësore nuk po i përmirësohet. Ka temperaturë deri në 40 gradë dhe se ka infektim e që nuk po dihet shkakun", kështu ka bërë me dije në një njoftim për medie KMDLNj.

Gjithnjë sipas informatës së familjarëve të Hysni Gucati, atij i është marrë një pjesë e indit për të bërë analizat për shkakun që po prodhon pasojë për shëndetin e Hysni Gucati sikur që është infeksioni i vazhdueshëm dhe zjarrmi të lartë. "Familjarët e Hysni Gucati i kanë deklaruar KMDLNj-së se gjatë dhe pas operacionit nuk u është lejuar vizita, madje as gruas së kryetarit

të dënuar të OVL-së së UÇK-së përkundër faktit se kanë kërkuar me këmbëngulje këtë. Gjithashtu, familjarët por edhe mbrojtësi kanë kërkuar të kenë qasje në dosjen shëndetësore përkatësisht ta mësojnë diagnozën e sëmundjes së Gucati por se nuk i është treguar", është bërë me dije në njoftimin e KMDLNj-së.

Sipas KMDLNj-së, pas këtyre refuzimeve dhe duke u thirrur dhe duke besuar se Gjykata Speciale është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës, i janë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë në Prishtinë me kërkesë të sigurohet mundësia që me ndihmën e kësaj ministrie, të vizitohet Hysni Gucati gjatë tërë kohës së trajtimit mjekësor por, sipas KMDLNj-së, familjarët nuk janë të kënaqur me premtimet dhe angazhimin nga kjo ministri. "KMDLNj ka sqaruar familjen e Gucati se MD-ja nuk ka asnjë qasje e as ndikim në trajtimin e të burgosurve të Gjykatës Speciale dhe se të drejtën ekskluzive për këtë e kanë Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit në Gjenevë dhe Avokati i Popullit i Holandës dhe se këto janë adresat ku ata duhet t'i adresojnë shqetësimet për shkelje të drejtave të njeriut të personave të burgosur në Njësinë e Paraburgimit në

Hagë, që të gjithë shqiptarë dhe të gjithë shtetas të Kosovës e që janë më se evidente", theksohet në njoftimin e KMDLNj-së.

KMDLNj ka treguar se edhe më herët e ka informuar opinionin se për shkak të kalkulimeve të Gjykatës Speciale, ndërhyrja kirurgjike të Gucati është bërë me vonesë, "dhe vetëm pasi ishte dënuar thuaja me dënim kapital prej 4.5 vjetëve me burg e që, thuaja ishte përmbushje e kërkesës së Prokurorit të "Specializuar" që kërkonte dënim maksimal prej 6 vjetëve burg për Hysni Gucatin dhe Nasim Haradinajn".

KMDLNj ka theksuar se është shqetësuar për gjendjen shëndetësore të Hysni Gucati, Salih Mustafës dhe Jakup Krasniqit, duke kërkuar nga organizatat monitoruese (ndërkombëtare) që t'i ngrehin këto shqetësime si shkelje e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria e që janë të garantuara me të gjitha dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në kohën kur Gjykata Speciale, me Rregulloren për trajtimin e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria, përveç Rregullave Evropiane të Burjeve ka integruar edhe

Rregullat e Nelson Mandeles, si standardi më i lartë i trajtimit që parashihet nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. "Në rastin konkret këto janë vetëm në letër. Në anën tjetër, Kuvendi i Kosovës, si themelues i Gjykatës Speciale e ka për detyrim që përmes Komisionit për të Drejtat e Njeriut seriozisht të trajtojë këto shqetësime duke i adresuar edhe në një seancë të Kuvendit, si pikë e rendit të ditës apo si temë e veçantë. Kjo në asnjë mënyrë nuk nënkupton se Kuvendi i Kosovës, Ministria e Drejtësisë apo ndonjë institucion tjetër po ndërhyjnë në drejtësi por se e kanë detyrim që të interesohen për trajtimin e shtetasve të Kosovës, të burgosur në Njësinë e Paraburgimit në Hagë sikur që kanë për detyrim interesimin për trajtimin e të privuarve nga liria dhe të dënuarve që janë të vendosur në qendrat e paraburgimit dhe qendrat korrektuese në territorin e Kosovës", ka njoftuar KMDLNj, duke theksuar se në rastin e Hysni Gucati ka shkelje flagrante të të drejtave të njeriut, përkatësisht mosdhënie të shërbimeve shëndetësore me kohë sikur që edhe mosdhënie e mundësive të trajtimit mjekësor jashtë qendrës ku mbahet tani.

Price: Kosova ta themelojë asociacionin, situata në veri ka potencial të eskalojë



PRISHTINË, 9 NËNTOR - Zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Ned Price, ka thënë se Kosova dhe Serbia duhet t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura në bisedimet e lehtësuara nga Bashkimi Evropian, përfshirë edhe atë për themelimin e Asociacioni të Komunave me Shumicë Serbe.

Në konferencën e përditshme me gazetarë, Price ka thënë se Shtetet e Bashkuara pajtohen me vlerësimin e Bashkimit Evropian se zhvillimet e fundit në veriun e Kosovës janë shqetësuese. "Ato vënë në rrezik përparimin e rëndësishëm që është arritur në dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Largimi i serbëve të Kosovës nga institucionet e Kosovës nuk është

zgjdhje për mosmarrëveshjet aktuale dhe ka potencial për ta përshkallëzuar më tutje situatën në terren. Të gjitha palët duhet të ndërmarrin hapa për t'i ulur tensionet dhe për të siguruar paqe dhe qëndrueshmëri", ka thënë Price.

Punonjësit serbë në veriun e Kosovës dhe përfaqësuesit e tyre politikë vendosën të tërhiqen nga të gjitha institucionet vendase pas mospajtimeve me vendimin e qeverisë qendrore në Prishtinë për konvertimin e targave të makinave të lëshuara nga Serbia, duke krijuar një situatë të tensionuar në zonë. Beogradi zyrtar tha se kthimi i tyre do të varet nga veprimet e mëtejme të Prishtinës. "Veprimet e retorikat që rrisin mundësinë e dhunës,

vetëm se vënë në rrezik të panevojshëm jetët e qytetarëve të pafajshëm dhe të trupave paqeruajtëse ndërkombëtare. Kosova e Serbia duhet t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e nënshkuara tashmë në dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Këtu përfshihet edhe fillimi i negociatave për ta themeluar Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe", ka zëdhënësi Price.

Qeveria e Kosovës më 1 nëntor filloi zbatimin shkallë-shkallë të vendimit për konvertimin e targave të makinave të lëshuara nga Serbia, me gjithë thirrjet e Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian për një shtyrje prej dhjetë muajsh për t'i

shmangur tensionet dhe për të krijuar hapësirë për arritjen e një marrëveshjeje për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në dritën e një propozimi franko-gjerman që mbështetet nga Shtetet e Bashkuara.

Ndihmësekretarja amerikane e shtetit, Karen Donfried, ka thënë se "ne në administratën e (Joe) Bidenit kemi kërkuar një zgjatje të plotë të periudhës së zbatimit të çështjes së targave, jo një zbatim me faza ose zgjatje të pjesshme. Dhe ne do të vazhdojmë ta vëzhgojmë nga afër këtë situatë. Këto diskutime janë në vazhdim, ndaj nuk dua të parashikoj veprime dhe hapa të veçantë që po diskutojmë apo planifikojmë, por

jemi shumë të angazhuar në vëzhgimin e situatës", ka thënë ajo. Donfried ka theksuar se rruga përpara është dialogu i lehtësuar nga BE-ja dhe nëpërmjet tij Serbia dhe Kosova duhet të arrijnë në një marrëveshje gjithëpërfshirëse të përqendruar në njohjen e ndërsjellë që hap derën e integritimit evropian. "Dhe ne kemi propozimin franko-gjerman për një rrugë përpara, të cilin e mirëpritëm sepse menduam se ishte e rëndësishme që marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë të vendoseshin në kuadër më të gjerë strategjik në vend që të vazhdohej me përqendrimin në këto çështje më të ngushta të targave", ka deklaruar Donfried.

Tahiri: Shtimi i pranisë së EULEX-it rrezikon ta kthejë veriun në protektorat

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Ish-kryenegociatorja e Kosovës për bisedime me Serbinë, Edita Tahiri, ka kërkuar shpjegime nga Qeveria e Kosovës për shtimin e pranisë së EULEX-it në veri të vendit. Ajo ka shkruar në "Facebook" se shtimi i kësaj pranie mund ta kthejë veriun e vendit në protektorat. "Shtimi i pranisë së EULEX-it në veri i shërben qetësisë dhe sigurisë, mirëpo kjo rrezikon ta kthejë në protektorat veriun, të cilin e synon Serbia. Qeveria duhet të japë

shpjegime si u rrit prania e EULEX-it në veri. A u kërkuar leje nga qeveria apo, ndoshta, kjo qeveri kaq lehtë dorëzon sovranitetin në veri të cilin e arritëm me shumë mundësi përmes dialogut të Brukselit. Ne qeveritë e kaluara e shtrimë sovranitetin në veri, e vendosëm policinë shtetërore në veri dhe kufirin verior, i vendosëm institucionet e drejtësisë dhe të tjera, ndërsa i shuam strukturat paralele serbe. Është urgjente të mbrohet veriun dhe t'i rikthehet sovraniteti shtetit të

Kosovës në veri", ka thënë Tahiri.

Më 8 nëntor një Njësi Policore e Specializuar Rezervë (NJPSR), e përbërë nga 23 xhandarë nga karabinierët italianë dhe anëtarë të Forcës së Xhandarmërisë Evropiane (EUROGENDFOR), kanë zbarkuar përkohësisht në Kosovë për t'i përforcuar kapacitetet e Njësisë Policore të Specializuar (NJPS) ekzistuese të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX).



Shqyrtohet "Projekt-rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil"

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Në vazhdim të diskutimeve publike është shqyrtuar "Projekt-rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil" në takimin e Asociacionit të Komunave me Kolegjin e Menaxherëve të Personelit në komuna me qëllim të shqyrtimit të rregullores dhe dhënies së rekomandimeve.

Duke pasur parasysh se edhe Ligji për Zyrtarët Publikë është në procedurë të ndryshimit, nënkuptoj se edhe rregullorja do të kishte ndryshimet e saj, me të cilat ndryshime menaxherët e komunave nuk u pajtuan ngaqë konsideruan se janë bërë lëshime ose nuk është trajtuar në nivelin e duhur rregullimi i personelit në nivelin lokal.

Ligji për Zyrtarët Publikë ka ngarkuar me punë shtesë zyrat e personelit nëpër komuna, për dallim nga niveli qendror që procedurat e personelit i zhvillon vetëm një ministri përkatëse,

respektivisht Departamenti i Zyrtarëve Publikë për të gjitha ministrinë e linjës, kurse në komunë zyra e personelit i zhvillon të gjitha procedurat për zyrtarët civilë dhe publikë, ndërkaq menaxheri i personelit është shërbyesi civil më i lartë në komunë.

Pozita e menaxherit të personelit është paraparë si pozitë e veçantë edhe në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe përgjegjësitë që i ka dhënë Ligji për Zyrtarët Publikë e kategorizojnë në nivelin menaxhues të mesëm dhe kjo kërkesë duhet të trajtohet nga ana e ministrisë e cila e ka hartuar Projekt-rregulloren.

Po ashtu, kishte edhe vërejtje të tjera të cilat janë dhënë në nene të caktuara dhe është kërkuar sqarim pasi ndryshimet e bëra duhen arsyetuar sipas ecurive të kohës dhe zhvillimit të administratës.



AKK-ja do t'i drejtohet me shkrim me të gjitha kërkesat rekomandimet dhe vërejtjet e paraqitura nga menaxherët e

personelit ministrisë sponzorizuese të projekt-rregullores dhe do të kërkojë që të merren parasysh rekomandimet

pasi janë të argumentuara dhe të arsyetuara sipas përgjegjësisë dhe gamës së punës së personelit nëpër komuna.

"Varfërimi i grave, fuqizim ekonomik apo pavarësim financiar?"



PRISHTINË, 9 NËNTOR - Mungesa e mundësive, paga e vogël, aspektet financiare, sociale dhe kulturore, edukimi më i madh i grave, qasja shumë e vogël janë disa nga çështjet të cilat u diskutuan në "Sallonin e së martës" me temë "Varfërimi i grave, fuqizim ekonomik apo pavarësim financiar?".

Për të diskutuar rreth kësaj teme të ftuar kanë qenë Hykmete Bajrami, deputete në Kuvendin e Kosovës dhe Edi Gusia, kryeshefe ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore.

Ky sallon është moderuar nga redaktorja Natyra Rushiti, e cila do ta shkruajë edhe editorialin për këtë temë.

Gjatë këtij diskutimi, Edi Gusia, kryeshefe ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, ka potencuar se

një ndër faktet për varfërimin e grave është qasja shumë e vogël e grave në tregun e punës, pasi vetëm 21 për qind e grave janë aktive në tregun e punës. Ajo ka theksuar se i vetmi investim që është duke u bërë aktualisht është TIK.

Ndër të tjera, Gusia ka theksuar se përqindja e grave më pak të punësuar janë gratë e moshës së mesme dhe arsyeja pse numri i kësaj moshe të grave është më e papunësuar është se tek to nuk është investuar dhe nuk është punuar.

Ndërsa Hykmete Bajrami, deputete në Kuvendin e Kosovës, është shprehur se do të kalojë një kohë e gjatë që gratë të kenë qasje në asete financiare. Ajo ka thënë se "ka qasje të vogël në aspektin financiar", është shprehur Bajrami.

Banka Botërore dhuron donacion për QKMF-në e Podujevës

PODUJEVË, 9 NËNTOR - Banka Botërore ka dhuruar donacion në vlerë mbi 16 mijë euro me pajisje të ndryshme për nevoja të shërbimit emergjent për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë.

Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Podujevë, Adelina Stublla, ka vizituar hapësirat e QKMF-së dhe me këtë rast ka shfrytëzuar rastin t'i shohë pajisjet të cilat i janë dhuruar QKMF-së nga Banka Botërore.

Drejtoresha Stublla ka uruar stafin e emergjencës në QKMF për pranimin e këtyre pajisjeve moderne të cilat do të ndihmojnë që shërbimet emergjente të jenë sa më efikase.

Donacioni përfshin EKG me monitor, defibrilator me

monitor, defibrilator automatik i jashtëm AED, sistem i kompesionit të gjoksit, aspirator (dy copë), cilindër oksigjeni (dy copë), çantë për ambulancë, jakë lidhëse, çantë paramedike, çantë mjeku, batanije termike nga alumini, komplet i ndihmës së parë, barelë lëvizëse transporti, barelë për raste traumatike, barelë kurizore, dyshek me ajër, jakne evakuimi, karrige kardiologjike, batanije për mbrojtje nga zjarri, fiksë zjari, shportë depoizimi.

Drejtoresha Stublla në emër të komunës së Podujevës e ka falënderuar Bankën Botërore për këtë donacion shumë të vlefshëm për QKMF-në, i cili, sipas saj, ndikon në përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve mjekësore.



Pas situatës në veri, EULEX-i përforcohet me 23 xhandarë nga Italia

EPOKA
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Më 8 nëntor një Njësi Policore e Specializuar Rezervë (NJPSR), e përbërë nga 23 xhandarë nga karabinierët italianë dhe anëtarë të Forcës së Xhandarmërisë Evropiane (EUROGENDFOR), kanë zbarkuar përkohësisht në Kosovë për t'i përforcuar kapacitetet e Njësisë Policore të Specializuar (NJPS) ekzistuese të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). NJPSR u dislokua në Kosovë si përgjigje ndaj nevojës së misionit për të pasur forca shtesë në terren dhe për t'i mbështetur më mirë homologët tanë kosovarë nëse kjo kërkohet dhe nëse është e nevojshme. NJPS-ja e rregullt e EULEX-it, e përbërë nga 105 policë polakë,

është e stacionuar në Mitrovicë dhe është reaguesi i dytë i sigurisë në Kosovë, që është pjesë përbërëse e mekanizmit me tre nivele të reaguesve të sigurisë, ku Policia e Kosovës është reaguesi i parë i sigurisë, EULEX-i është i dyti, kurse NATO/KFOR-i i treti.

NJPSR-ja e sapozbarkuar aktualisht përbëhet nga 23 xhandarë nga karabinierët italianë dhe është e vendosur në Kompleksin Mbështetës të EULEX-it në Fushë-Kosovë. NJPSR-ja është nën komandën e EULEX-it dhe do ta mbështesë misionin për përmbushjen e detyrave të tij, përfshirë ato si reagues i dytë i sigurisë në Kosovë nëse është e nevojshme. Siguria e grave, burrave, vajzave dhe djemve nga të gjitha komunitetet në Kosovë është prioriteti kryesor i EULEX-it dhe



zbarkimi i Njësisë Policore të Specializuar Rezervë e tregon vendosmërinë e EULEX-it që të vazhdojë ta mbështesë stabilitetin e Kosovës dhe të kontribuojë në sigurinë e popullatës së saj. Kjo është hera

e dytë që një NJPSR zbarkon në Kosovë: në mars 2022, EULEX-i e përforcoi përkohësisht NJPS-në e tij me një njësi rezervë prej 70 xhandarësh nga Portugalia dhe Franca. Xhandarët u larguan nga Kosova më 18

korrik. Forca e Xhandarmërisë Evropiane është një forcë policore shumëkombëshe operationale, e organizuar paraprakisht, e fuqishme dhe e dislokueshme me shpejtësi.

Policia arreston 14 persona në disa "Call Center" në Prishtinë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Autoritetet në Kosovë kanë arrestuar 14 persona, punonjës të "Call Center" (Qendër e Thirrjeve) në Prishtinë. Të arrestuarit dyshohen për veprat penale "hyrje në sistemet kompjuterike", "mashttrim" dhe "pastrim parash". I dyshuari kryesor në këtë rast, sipas autoriteteve, është shtetas i huaj.

Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar se ky aksion është ndërmarrë pas hetimeve disamujore në bashkëpunim me autoritetet e Gjermanisë.



"Ekziston dyshimi i bazuar se këta persona kanë regjistruar si biznes 'Qendër të Thirrjeve' në Kosovë dhe përmes saj kanë komunikuar

përmes telefonit me shtetas të ndryshëm, përfshirë edhe gjermanë. Gjatë komunikimeve kanë arritur t'i mashtrojnë të

dëmtuarit duke i shtyrë të investojnë në platforma të ndryshme digjitale gjoja për investime. Për realizimin e mashtimit të dyshuarit kanë përdorur edhe sistemin kompjuterik-përdorimi i softuerëve për qasje nga distanca si dhe krijimin dhe përdorimin e faqeve në internet", është thënë në njoftimin e Prokurorisë Speciale.

Sipas Kodit Penal të Kosovës për veprën penale "hyrje në sisteme kompjuterike", nëse një person ka shkaktuar dëm prej 10 000 eurosh, atëherë ai mund të dënohet nga gjashtë muaj deri në pesë vjet burgim. Për veprën

penale të "mashtimit", ndëshkimet bazohen në dëmin material të shkaktuar dhe sillen nga tre muaj deri në 10 vjet burgim.

Ndërkaq, për veprën penale "shpëlarje e parave", parashihet dënim me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet. Gjatë aksionit të zhvilluar në disa lagje të Prishtinës më 8 nëntor, Prokuroria bëri me dije se janë sekuestruar një sërë provash, përfshirë dy vetura, 167 kompjuterë, tre laptopë, telefona mobilë dokumente të ndryshme dhe prova të tjera elektronike. Të 14 personat e arrestuar janë dërguar në mbajtje për 48 orë.

LB-ja: Pse është e domosdoshme që Kosova Lindore të bëhet pjesë e dialogut Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Lëvizja për Bashkim (LB) ka theksuar se që në fillimet e tij e në vazhdimësi dialogu Kosovë - Serbi ka qenë i vendosur mbi premisa të gabuara. Sipas kësaj partie, është biseduar e po bisedohet vetëm për serbët e Kosovës, përkatësisht veriu e Kosovës e po lihen anash padrejtësisht shqiptarët e Kosovës Lindore (Preshevë, Bujanoc e Medvegjë).

LB-ja ka theksuar se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk mund të gjejë zgjidhje afatgjatë dhe demokratike nëse Kosova Lindore nuk bëhet pjesë e këtij dialogu. "Është kështu për shumë arsye: E para, është vullnet i popullatës shumicë, i shprehur me të gjitha format legale demokratike, dhe se është pjesë natyrore e trungut të Republikës së Kosovës, me vazhdimësi

territoriale dhe me shumicë shqiptare; E dyta, është detyrë e secilës palë të përfshirë në dialog që të angazhohet për arritjen e një marrëveshjeje sa më të drejtë, një marrëveshjeje që sjell paqe, stabilitet dhe zhvillim afatgjatë për të gjitha këto palë; E treta, përfshirja e Kosovës Lindore në dialogun Kosovë - Serbi është çelësi demokratik për të gjitha palët në dialog, i cili çon në zgjidhje me paqe, stabilitet dhe zhvillim afatgjatë; E katërta, e balancon dialogun. Dhe, në fund, Kosova Lindore duhet të përfshihet në dialog sa më shpejt, në mënyrë që banorët e kësaj pjese të shohin një perspektivë për jetën e tyre, ta ngjallin shpresën se do të shpëtojnë nga diskriminimi shekullor që përjetuan nga shteti serb", është thënë në komunikatën e LB-së.



Gërxhaliu kundër ligjit që përcakton çmimet dhe sasinë e produkteve që mund të blihen

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Ligji për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në Raste të Veçanta të Destabilizimit në Treg, përveç të tjerash, parasheh që të ketë edhe kufizime në sasi për një produkt që i shitet konsumatorit brenda periudhës së caktuar. E për këtë ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Safet Gërxhaliu, ka thënë se me kufizim sasi dhe caktim të

çmimeve bizneset e vogla nuk do të mund të mbijetojnë. Sipas tij, ky ligj jo vetëm që është antikushetues, por e dëmton edhe ekonominë e tregut.

Gërxhaliu ka theksuar se është për keqardhje që disa ekonomistë thonë se na duhet një ligj i tillë. "Kosova është shndërruar në hapësirë eksperimentale. Agjenda politike është duke dominuar dhe problemet ekonomike po

preken vetëm shkarazi dhe jo në substancë. Në këtë drejtim rekomandimet e ekspertëve po hasin në vesh të shurdhër. Ligji për produktet esenciale është antikushetues, e dëmton ekonominë e tregut. Më vjen keq kur i dëgjoj ekspertët e ekonomisë duke thënë se Kosovës i duhet një ligj i tillë. Përpos që po dëmtohet sektori privat, po dëmtohen edhe qytetarët e Kosovës. Dhe keni parasysh se monitorimi i këtij

ligji do të jetë i zbehtë", është shprehur ai.

Gërxhaliu ka thënë se Kosova nuk ka nevojë për një ligj të tillë, por për mekanizma të tjerë, duke shtuar se ligjet nuk duhet të jenë për interesa të partive politike, por për interesa të qytetarëve.

Ditë më parë Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Masat e Përkohshme të Produkteve Themelore në raste të veçanta të destabilizimit në treg.



Kurti: Qeveria është duke adresuar seriozisht ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave

PRISHTINË, 9 NËNTOR - Konferenca e përbashkët ballkanike është ngjarja më e rëndësishme për profesionistët e fushës së ujërave të Shqipërisë, të Kosovës, të Maqedonisë së Veriut e të Malit të Zi. Kështu ka thënë kryeministri Albin Kurti në hapje të konferencës dhe të ekspozitës së 10 të Përbashkët Ballkanike "Ujërat nëntokësorë - të bëjmë të padukshmen të dukshme".

Kryeministri Kurti ka theksuar se për më tepër kjo konferencë e përvitshme mban në vëmendje rëndësinë jetike që ka furnizimi me ujë dhe shërbimet e kanalizimit, si dhe promovon shkëmbimin e përvojave teknologjike dhe ofron një perspektivë për profesionistët e rinj të sektorit. Më tej, kryeministri Kurti ka potencuar se mbetet i dukshëm injorimi prej dy dekadash i keqmenaxhimit, ndotjes dhe degradimit të burimeve ujore, nga eksploatimi i rërës dhe zhavorrit, tejshfrytëzimi, ndotja dhe mungesa e planifikimit, ndërsa ka theksuar se qeveria nën drejtimin e tij është mobilizuar në disa fronte për ta adresuar këtë sfidë: duke u nisur nga forcimi i kornizës ligjore dhe kthimi i ligjshmërisë për t'i adresuar lejet ujore si dhe koncesionet për shfrytëzuesit komercialë; e duke vazhduar me veprimet konkrete për adresimin e nevojës për ndërtimin e akumulimeve të reja, duke filluar nga ato që janë prioritet i padiskutueshëm, siç është diga e Firajës që do të



sigurojë ujë për rajonet e Ferizajt, Gjilanit dhe Prishtinës dhe diga e Kamenicës, për të siguruar ujin e nevojshëm për zonën më të thatë me ujëra.

Po ashtu, kryeministri Kurti tha se tashmë është iniciuar hartimi i studimeve të fizibilitetit për tri diga të reja:

Dragaqinë në Therandë, Pollatë në Podujevë dhe Kuçicë në Skenderaj, si dhe hartimi i një plani në nivel të Kosovës për ndërtimin e digave të reja, që është një përditësim i masterplanit të ujërave të vitit 1982, pra pas plot 40 vjetëve. "Qeveria, po ashtu, është duke

adresuar seriozisht ndërtimin e impianteve për trajtimin e ujërave - së fundmi e kemi inauguruar impiantin në Pejë, e në javët në vijim presim ta bëjmë edhe inaugurimin e impiantit në Gjakovë. Në rend janë impiantet rajonale të Prishtinës së bashku me Fushë-

Kosovën, Obiliqin dhe Graçanicën, dhe të Mitrovicës së bashku me Vushtrrinë, gjithashtu edhe impianti në Gjilan. Synojmë t'i përfundojmë studimet për trajtimin e ujërave të ndotura për 12 komunat e tjera me rend sipas madhësisë", ka thënë Kurti.

Shqipëri, pezullohet edhe për nëntorin rritja e çmimit të energjisë për mbi 800 kWh

TIJANË, 9 NËNTOR - Qeveria e Shqipërisë ka njoftuar se është tërhequr nga aplikimi për familjarët, i një çmimi disa herë më të lartë për konsumin e energjisë mbi 800 kilovat/orë për muajin nëntor. Me herët kishte qenë Korporata Energjetike prodhuesja kryesore e energjisë dhe furnizuesja që i kishte bërë me

dije operatorit të shpërndarjes së energjisë, pezullimin e aplikimit të tarifave të shtuara. Për pasojë, Entit Rregullator të Energjisë (ERE) i është kërkuar ta ndryshojë vendimin e tij për ta reflektuar mbajtjen të pandryshuar të çmimit pavarësisht prej konsumit. Të njëjtin veprim qeveria e ndërmoi edhe në muajin tetor,

pasi më parë kishte njoftuar zbatimin, deri në 31 dhjetor të këtij viti, të një plani tarifor me dy nivele, duke ruajtur çmimin prej 11.4-lekësh (9.5 lekë + TVSh) për konsumin deri në 800 kilovat/orë në muaj dhe një çmim disa herë më të lartë prej 50.4 lekësh (42 lekë + TVSh), për çdo kilovat/orë të konsumuar përtej këtij niveli.



Në Kiev i pashë ukrainasit në vijën e parë të luftës së vërtetë kulturore



Nga: Charlotte HIGGINS
The Guardian

Së fundmi në Kiev, në Operën Kombëtare të Ukrainës pashë shfaqjen e operës së kompozitorit ukrainas, Mikola Lisenko. Vepra simpatike dhe komike – që ishte edhe arratisje nga zymtësia e sulmeve me raketa ruse – quhet Natalka Poltavka, bazuar në një shfaqje të Ivan Kotliarevskit, i cili në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX ishte pionier i letërsisë në gjuhën ukrainase. Në skenë janë operat e Verdit, Puccinit dhe të Mozartit, dhe baletet si Zhizel dhe Silfid – pavarësisht srenave pothuajse të përditshme për sulme ajrore. Por, nuk ka Evgenij Onjegin, as një Mbretëreshë të maçit dhe as një pëshpëritje të temave kryesore të Çajkovskit në balet, si Bukuroshja e fjetur apo Liqeni i mjellmave. Letërsia dhe muzika ruse, kultura ruse e të gjitha llojeve, është jashtë menysë së Ukrainës së kohës së luftës. Ndaj, është gati tronditëse të kthehesh në Mbretërinë e Bashkuar dhe të dëgjosh muzikë ruse të transmetuar – në mënyrë indiferente – në Radio 3.

Jashtë Ukrainës, kjo mungesë – disa do të thoshin fshirje – mund të jetë e vështirë për t'u kuptuar. Kur një orkestër simfonike në Kardiif këtë pranverë hoqi nga programi Uverturën 1812, kishte huti që shkonin deri në protestë: eliminimi i Çajkovskit ia lejoi Vladimir Putinin dhe të afërmit të tij kënaqësinë e "zotërimit" të kulturës ruse – ishte censurë, ishte si t'ia jepje kontrollin Rusisë. Çajkovski jo vetëm se ka kohë që ka vdekur, por ka qenë kozmopolit dhe internacionalist – ishin disa nga argumentet. U desh

një shpjegim i kujdesshëm për të treguar se një vepër muzikore që lavdëron sukseset ushtarake ruse, dhe që ndërlidhet me topat aktualë, mund tejkalojë shijen e vobektë kur Rusia këtë moment bombardon qytetet e Ukrainës – sidomos kur familjet e anëtarëve të orkestrës drejtpërsëdrejti preken.

Në fakt, momentet e tilla kanë qenë të rralla në Evropën Perëndimore. Çehovi dhe Lermontovi vazhdojnë të lexohen, ndërsa Musorgski interpretohet. Kultura ruse nuk është "anuluar", siç thotë Putini, ndërsa muzikantët e valltarët rusë me karrierë ndërkombëtare vazhdojnë të performojnë në Perëndim – me pretendimin se dhanë minimumin e përcimit publik të vrasjeve dhe të shkatërrimeve që vazhdojnë në Ukrainë. Vetëm më naivët do ta dënonin largimin e Valeri Gergievit prej programeve koncertale ndërkombëtare. Dirigenti që shihet si i afërt i Putinit, mbështeti aneksimin rus të Krimesë të vitit 2014 (akt ky që nuk njihet nga shumica e vendeve të OKB-së), nuk ka pranuar të dënojë pushtimin aktual të shkallës së gjerë të Ukrainës, ndërsa ka histori të përdorimit të profilit artistik në shërbim të shtetit rus – siç ishte dirigjimi i koncerteve në Osetinë Jugore, të financuara nga Rusia në vitin 2008 në vazhden e luftës ruso-georgjiane.

Megjithatë, brenda Ukrainës gjërat duken shumë ndryshe. Për shumë njerëz, lufta aktuale me Rusinë shihet si "luftë dekolonizimi" – siç ka thënë poetja ukrainase Ljuba Jakimçuk – moment në të cilin Ukraina ka mundësinë të çlirohet, më në fund, nga të qenit objekt i imperializmit rus. Ky dekolonizim përfshin "refuzimin total të

materialeve dhe të kulturës ruse", siç kohën e fundit tha – në Forumin e Librit në Lviv – shkrimtari Oleksandër Mikhed. Këto nuk janë fjalë të lehta për t'u dëgjuar – jo nëse si unë ke kaluar adoleshencën e vonë duke u zhytur në historitë e Ana Kareninës, të Çehovit, të Tolstoit; jo nëse kohët e fundit ke rindezur dashurinë për tregimet e shkurta ruse, nëpërmjet librit të shkëlqyeshëm të George Saundersit – Noti në pellgun me shi; jo nëse e adhuron Stravinskjin dhe sigurisht se do ta merrnit një disk të Ritit të pranverës në ishullin tënd të vetmisë.

Megjithatë, konteksti për këtë refuzim duhet kuptuar: ukrainasit po dalin nga historia në të cilën perandoria ruse, dhe më pas Bashkimi Sovjetik, artin ukrainas e shtypte vazhdimisht dhe shpeshherë me dhunë. Kjo ka funksionuar në një sërë mënyrash të ndryshme. Në qendrën ruse ka përfshirë përvetësimin e shumë artistëve dhe shkrimtarëve ukrainas (si Nikolai Gogol, ose Mikola Hohol në gjuhën ukrainase) dhe klasifikimin e gabuar të qindra artistëve si rusë – kur ata mund të përshkruhen më mirë si ukrainas (si p.sh. piktori Kazimir Maleviq që lindi në Kiev, por që ishte rus sipas Galerisë "Tate"). Kjo do të thotë se shkrimi në gjuhën ukrainase me raste ka qenë i ndaluar – poetit kombëtar të Ukrainës, Taras Shevçenko, Car Nikolla I ia ndalon krejtësisht të shkruajë, për një dekadë. Kjo heshtje ka përfshirë shfarosjen e artistëve ukrainas, si vrasjet – nën Stalinit – të qindra shkrimtarëve në vitin 1937, të njohura si "Rilindja e ekzekutuar". Pas gjithë kësaj qëndrojnë ngjarjet e tmerrshme – si Holodomori, vdekja nga uria e

rreth 4.5 milionë ukrainasve në vitet 1932-33, në përpjekjet e tyre të detyruara, me urdhrat e Stalinit, për të prodhuar grurë.

Kjo histori e vendos Ukrainën në një pozicion krejt ndryshe në lidhje me kulturën ruse, sesa – të themi – Britania që gjeti veten në lidhje me artin gjerman dhe austriak gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur gjatë blickrigut Myra Hess interpretonte Mozartin, Bachun dhe Beethovenin në koncertet e saj në Galerinë Kombëtare. "Kemi pasur pushtim kulturor, pushtim gjuhësor, pushtim arti dhe pushtim me armë. Nuk ka shumë dallim mes tyre", më thotë kompozitori Igor Zavgorodni. Në periudhën sovjetike, kultura ukrainase lejohej të ishte si e padëmshme popullore – dhe ukrainasit e paraqitur si zgjedhë e dehur e veshur me pantallona kozake, shpeshherë ishin objekt të shakave nënçmuese. Por, nga Ukraina nuk pritej, apo nuk lejohej, të kishte kulturë të lartë të sajën. Në të njëjtën kohë, arritjet artistike ruse u vlerësuan si kulmi i madhështisë njerëzore. "Jemi rritur në njëfarë devotshmërie ndaj letërsisë ruse", shpjegon dramaturgia Natalia Vorozhbit, që është edukuar në periudhën sovjetike. "Nuk kishte devotshmëri të tillë ndaj asnjë letërsie tjetër".

Në fakt, vetë Putini ka dyfishuar tërë këtë përmes këmbënguljes së tij të vazhdueshme, përmes eseve dhe shpeshherë fjalimeve të rrëmujshme se Ukraina nuk ka ekzistencë të ndarë nga Rusia – se nuk ka identitet, asnjë kulturë, përveçse si ndihmëse e fqinjit të vet. Në të vërtetë, pretendimi për pandashmërinë kulturore të Rusisë nga Ukraina, është një prej arsyesimeve kryesore të tij për

pushtimin. Në të njëjtën kohë, është tepër flagrant instrumentalizimi rus i historisë së saj artistike. Në Hersonin e pushtuar, tabelat që shpallin atë si "qytet me histori ruse", shfaqin imazhin e Pushkinin që vizitoi qytetin në vitin 1820. Artistët ukrainas janë gjithashtu kundër projekcionit të Rusisë si komb i madh i shkëlqimit artistik, që në mënyrë më të përgjithshme vepron si mjet i fuqisë së butë, si një lloj i gumëzhimit pozitiv ambiental që, do thoshin ata, zbut brutalitetin e vërtetë të pushtimit të sotshëm. Në Ukrainë ekziston klithma e përgjithësuar ndaj "mutsihanës" në lidhje me mitin e "shpirtit rus".

Disa ukrainas me të cilët unë flas, shpresojnë se një ditë, përtej fundit të luftës, do të ketë mënyra për të konsumuar letërsinë dhe muzikën ruse – por, së pari duhet bërë puna e dekolonizimit, përfshirë këtu rileximin dhe rivlerësimin e autorëve klasikë, duke zbuluar se si ata reflektuan dhe se si herë pas here projektuan vlerat e perandorisë ruse. Ndërkohë, "Fëmija im do të jetë krejt në rregull nëse rritet pa Pushkinin apo Dostojevskin", thotë Vorozhbit. "Nuk më vjen keq për këtë".

Për shumë ukrainas që takoj, koha për letërsinë ruse përsëri do të vijë – kur ajo mund të kuptohet në mënyrë kritike, thjesht si një degë tjetër e kulturës botërore, gjithashtu si forcë shtypëse dhe e dërmimit. Në Teatrin Kombëtar të Operës pyes koreografin Viktor Litvinov se kur mendon se Çajkovski – një kompozitor që ai e do – do të kthehet në program. "Kur rusi pushon së qeni agresor", thotë ai. "Kur Rusia pushon së qeni perandori e keqe". /Përktheu: Agron Shala - Telegrafil

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Prishtina mposhtet në Malishevë, fitojnë Dukagjini dhe Trepça '89

Një fitore për një skuadër vendase dhe dy për skuadrat mysafire janë regjistruar të mërkurën në Superligën e Kosovës në futboll. Prishtina e Ismet Munishit pësoi nga Malisheva, ndërsa fitore kanë shënuar Dukagjini dhe Trepça '89 në përballje me Drenicën, përkatësisht Ferizajn

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 9 nëntor - FC Prishtina ka pësuar humbje në përballje me Malishevën (2-1) në ndeshjen e vlefshme për javën e 16 në Albi Mall Superligën e Kosovës në futboll. Vendasit e nisën më mirë ndeshjen dhe shënuan pas tre minutave nëpërmjet Drilon Hazrollajt. Në minutën e 20 Prishtina u rikthye në lojë me golin që e realizoi mesfushori Endrit Krasniqi nga penalltia. Një minutë para fundit të kohës së rregullt, Malisheva shënoi golin e fitores ndaj skuadrës së drejtuar nga Ismet Munishi. Autor i golit ishte Medin Bajrami. Pas kësaj ndeshjeje, Prishtina është në vendin e tretë me 23 pikë, kurse Malisheva në vendin e pestë me 18 pikë. Të mërkurën fitore në Superligë kanë shënuar edhe Dukagjini dhe Trepça '89 në përballje me Drenicën, përkatësisht Ferizajn.

Skuadra nga Klina mposhti Drenicën me rezultat 0-1 në ndeshjen e zhvilluar në Skenderaj. Golin e vetëm në ndeshje e realizoi Altin Merlaku në minutën e 20. Në pjesën e dytë kuqezinjtë tentuan ta barazojnë rezultatin, por pa ndonjë sukses. Pas kësaj ndeshje Dukagjini është në vendin gjashtë me 18 pikë, ndërsa Drenica është dy pozita më poshtë me 17 pikë. Fitore të madhe ka shënuar Trepça '89 ndaj Ferizajt (2-3). Të parët në epërsi në pjesën e parë kaluan mysafirët me golin e Albion Pllanës, por vendasit nuk u dorëzuan dhe barazuan rezultatin me anë të një penalltie të realizuar nga Pandiq. Fazliu dhe Ojekambin shënuan dy gola të shpejtë për mysafirët, derisa Ferizaj shënoi edhe golin e dytë me anë të Fazliut për rezultatin final 2-3. Ferizaj është në vendin e fundit me 12 pikë, kurse Trepça '89 renditet e shtata me 18 pikë.



SOT DY DERBI NË SUPERLIGË

Dy ndeshje derbi të javës së 16 në Superligën e Kosovës në futboll zhvillohen sot (e enjte). Derbi më i madh në vend në mes të skuadrës së Gjilanit dhe Dritës zhvillohet nga ora 13:00. Edhe kësaj radhe kjo ndeshje pritet të jetë interesante për faktin se këto skuadra janë në krye të tabelës dhe kanë ambicie të mëdha në këtë edicion, por ambiciet e tyre shtohen edhe më shumë kur përballen me njëra-tjetrën. E

vetmja gjë që e prish hijeshinë e këtij derbi është mungesa e tifozëve. "Për shkak të kushteve jo të favorshme dhe mungesës së tribunave, takimi do të zhvillohet pa praninë e tifozëve dhe qëndrimi afër stadiumit do të jetë i ndaluar për shikues", thuhet në njoftimin e SC Gjilanit. Kjo është hera e dytë këtë sezon që në derbin më të madh në Kosovë do të mungojnë tifozët "Skifterat" dhe "Intelektualët". Aktualisht Drita është e para në tabelë, ndërsa Gjilani në vendin e katërt. Ndeshje derbi do të

zhvillohet edhe mes kampioneve në fuqi të Ballkanit dhe Llapit. Të dyja këto skuadra në këtë ndeshje luajnë për fitore.

SUPERLIGA - Java 16

Malisheva - Prishtina	2-1
Ferizaj - Trepça '89	2-3
Drenica - Dukagjini	0-1

Të enjten takohen:
13:00 Ballkani - Llapi
13:00 Gjilani - Drita



Peja - Ponte Prizreni hap edicionin në Ligën Unike

PEJE, 9 NËNTOR - Sot (e enjte) do të hapet zyrtarisht edicioni i ri në Ligën Unike të Meshkujve. Në këtë ligë garojnë katër skuadrat më të mira nga Kosova dhe Shqipëria. Gjithsej do të zhvillohen 14 xhiro, me vajtje-ardhje, ndërsa më pas do të përcaktohen katër skuadrat e para që do të garojnë në "play-

off" për titullin e kampionit. Peja është kampione e kësaj gare dhe synon ta mbrojë titullin e kampionit, ndërsa prizrenasit për herë të parë marrin pjesë në këtë garë dhe synojnë paraqitje sa më të mira. "Verdhezinjtë" janë të pamposhtur në këtë edicion me tetë fitore në Prince Caffë Superligën e Kosovës në

basketboll dhe një fitore në Ligën Ballkanike, kurse prizrenasit kanë tri fitore e katër humbje në elitën e basketbollit të meshkujve. Ndeshja zhvillohet të enjten (sot) nga ora 19:00. Rezultati i kësaj sfide është i vlefshëm edhe për Prince Caffë Superligën e Kosovës në basketboll.

Zvicra, me tre shqiptarë në Kupën e Botës, 'harrohet' Zeqiri

CYRIH, 9 NËNTOR - Kombëtarja e Zvicrës është pjesë e Grupit G në Kupën e Botës, aty ku bëjnë pjesë edhe Brazili, Serbia dhe Kameruni. Trajneri Murat Yakin ka publikuar listën e 26 lojtarëve që do ta përfaqësojnë kombëtaren helvete

në Katar 2022. Mes lojtarëve të grumbulluar janë tre lojtarë shqiptarë: kapiteni Granit Xhaka (Arsenal), Xherdan Shaqiri (Chicago Fire) dhe Ardon Jashari (Luzern). Ky i fundit është 20 vjeç dhe luan si mesfushor shkatërrues tek ekipi zviceran. Jashari ka

lindur në Zvicër dhe është një prodhim i klubit të Luzernit. Ai po zhvillon paraqitje shumë të mira në kampionatin helvet dhe deri në këtë fazë të sezonit numëron 14 ndeshje me Luzernin. Lista e futbollistëve: M. Aebischer, M. Akanji, E. Comert, B. Embolo,

Ch. Fassnacht, E. Fernandes, F. Frei, R. Freuler, A. Jashari, G. Kobel, P. Kohn, N. Okafor, J. Omlin, F. Rieder, R. Rodriguez, F. Schar, H. Sefereoviq, Xh. Shaqiri, Y. Sommer, D. Sow, R. Steffen, R. Vargas, S. Widmer, G. Xhaka, D. Zakaria.



Dy klube spanjolle e duan Muriqin

Mallorca, 9 nëntor - Sulmuesi Vedat Muriqi po shkëlqen me fanellën e Mallrocas në La Liga. Pas shtatë golave të shënuara,

reprezentuesi i Kosovës ka tërhequr interesimin e dy klubeve spanjolle. "Diariodemallorca" raporton se prizrenasin e do

Sevilla, e cila nuk është e kënaqur me sulmuesit aktualë Rafa Mir e En Nesyri. Ish-futbollistin e Lazios po e pëlqen edhe Villarreali. Pas

përformacës së mirë, nuk përjashtohet mundësia që Muriqin ta shohim në një klub më të madh spanjoll në vitin 2023.

Trajneri i lakersave, pas fillimit të keq: Nuk kam ardhur këtu për të humbur

LOS ANXHELOS, 9 NËNTOR - Sezoni 2022-2023 për skuadrën e LA Lakers ka nisur mjaft keq, me vetëm dy fitore në 10 ndeshje të luajtura deri më tani, duke u renditur në vendin e parafundit në Konferencën e Perëndimit. Ndonëse pritej një fillim tjetër, skuadra e drejtuar

nga trajneri Darvin Ham ka zhgënjyer deri më tani. Gjithsesi, trajneri Ham shprehet se është vetëm çështje kohe që situata të ndryshojë për mirë, pasi ai ka vetëm pak muaj që po punon me skuadrën. "Miqhtë e mi, dua t'ju them një gjë. Ajo që po kalojmë

tani është një situatë që mund t' i ndodhë çdo skuadre, pasi jemi në fillimin e asaj që ne po përpiqemi të ndërtojmë, si një ndryshim në kulturën e të luajturit basketboll", ka thënë Ham. "Është një ndryshim që po bëjmë për t' u rikthyer në majë, për të qenë sërish

kompetitivë, duke ndërtuar një bazë të fortë. Nuk ka për të qenë gjithnjë kështu. Së shpejti do të ketë një ndryshim në tendencën e rezultateve. Unë s'kam ardhur këtu për të humbur dhe Lakersi nuk më solli këtu për të humbur", ka shtuar Ham.



Ndërpritet ndeshja Shkupi - Shkëndija

TETOVË, 9 NËNTOR - Është ndërprerë ndeshja në mes të Shkupit dhe Shkëndijës që ishte duke u zhvilluar në kuadër të çerekfinales së Kupës së Maqedonisë së Veriut. Përballja nisi me një situatë të qetë, por gjithçka ndryshoi me golin e shënuar në minutën e 9. Tensionet filluan kur ekipi tetovar shënoi gol përmes Dashmir Elezit, ndërsa golashënuesi shkoi për të festuar afër tifo grupit "Shvercerat". Për ta qetësuar ngjarjen kanë ndërhyrë edhe forcat policore, por situata nuk është qetësuar. Edhe pas disa bisedimeve me tifozët shkupjanë, gjërat nuk u normalizuan dhe më pas rrodhi vendimi zyrtar se ndeshja duhej ndërprerë. "Dueli i çerekfinales së Kupës së Maqedonisë së Veriut ndërmjet Shkupit dhe Shkëndijës është ndërprerë pas vetëm 9 minutave lojë me rezultat momental 1:0 për Shkëndijën. Sulmi ndaj futbollistëve kuqezi, pas golit të



Elezit, hyrja e disa tifozëve vendas në terren dhe gjuajtjet me fishekzjarrë e gjësente të forta në drejtim të futbollistëve të Shkëndijës, bëri që fillimisht forcat e sigurisë ta urdhërojnë tërheqjen e ekipit të Shkëndijës në zhveshtore për shkaqe sigurie", thuhet në njoftimin e skuadrës së Shkëndijës. "Pas mbledhjes së delegatit, arbitrave të takimit, komisarëve të sigurisë së dy klubeve dhe FFM-së, përfaqësuesit e MPB-

së së Shkupit, përgjegjës për sigurinë e kësaj ndeshje dhe përgjegjësve nga Komisioni për Gara pranë FFM-së, u vendos se nuk ka kushte sigurie për vazhdimin e ndeshjes. Për vendim përfundimtar rreth epilogut pasojnë raporte shtesë për ngjarjet në këtë ndeshje nga ana e delegatit, përfaqësuesit për siguri pranë FFM-së dhe arbitrave të ndeshjes", thuhet në njoftimin e skuadrës nga Tetova.

Bagnaia: Besova te titulli edhe kur isha 91 pikë pas kreut, vendosmëria u shpërblye

TURIN, 9 NËNTOR - Festa e titullit kampion bote në MotoGP ka zgjatur deri në orën një të natës për Francesco Bagnaia, që është larguar nga mbrëmja e organizuar nga Ducati më herët nga të gjithë. "Isha shumë i lodhur nga ajo ditë, që m'u duk shumë e gjatë. Isha i uritur, pa energji dhe shkova të fle, ndërkohë që skuadra festonte ende", ka thënë piloti italian. "Nuk ndihesha mirë, pasi kisha marrë edhe një të ftohur atë pasdite, duke kaluar nga një intervistë në tjetrën. Më pas shkuam në mbrëmjen 'gala' që organizoi MotoGP dhe në fund në festën e skuadrës", ka thënë Bagnaia, që kujton orët e para si kampion bote për pilotët. "Ka qenë një sezon i gjatë, i lodhshëm dhe i vështirë. Në mesin e sezonit as që mund të mendonim për titullin, pasi isha 91 pikë pas Quartararos. Gjithsesi, nuk hoqëm dorë dhe mendoj se vendosmëria e të gjithëve u shpërblye. Morëm dy tituj, atë për



pilotë dhe konstruktorë dhe festa është legjitime", ka shtuar Bagnaia. "Ndihma e personave që kisha pranë ka qenë e madhe dhe ata kanë qenë gjithçka për mua. Shpresoj që ky triumf të jetë një motivim më i madh për të

ardhmen. Përvoja e këtij viti ishte vendimtare për karrierën time. Tani kemi më shumë përvojë dhe mendoj se kjo do të më ndihmojë që të shpallmë kampion edhe vitin tjetër", ka deklaruar Francesco Bagnaia.

SHKURT

Mane humbet Kupën e Botës

Bayern Munchen e shkatërroi Werder Bremenin me rezultat 6-1, por lajm i keq është lëndimi i Sadio Manes. Ish-ylli i Liverpoolit pësoi një lëndim në gju dhe u largua në minutën e 20 nga loja. Mediumi francez "L'Equipe" raporton se Mane do ta humbasë tashmë Kupën e Botës "Katar 2022".

Ancelotti: Benzema nuk rrezikon Kupën e Botës

Karim Benzema nuk ka luajtur që nga 19 tetori dhe do të mungojë nesër edhe kundër Cadizit. Carlo Ancelotti, në konferencën për shtyp, i qetëson të gjithë në lidhje me situatën e Benzemas. "Dëmtimi i parë kundër Celticut është rikuperuar, por problemet e fundit nuk janë aspak shqetësuese. Ai nuk rrezikon të luajë në Kupën e Botës. Ka dëmtime të lehta. Unë nuk jam i shqetësuar. Ai u përpoq të rikuperohej, por Karim nuk do të jetë i gatshëm për ta ndihmuar ekipin. Nuk ka probleme serioze. Ai ofendohet kur lexon dhe dëgjon se nuk do të mund të luajë në Kupën e Botës. Ai po bëhet gati", ka thënë Ancelotti.

City në bisedime me Dortmundin për Bellinghamin

Manchester City ka zhvilluar bisedime me Borussia Dortmundin për shërbimet e Jude Bellinghamit, sipas "Daily Mail". Pep Guardiola ka lavdëruar reprezentuesin anglez dhe dëshiron t'i sigurojë shërbimet e mesfushorit. Megjithatë, ata përballen me konkurrencë të ashpër nga Real Madridi dhe Liverpooli. 19-vjeçari ka kontratë të vlefshme me Dortmundin deri më 30 qershor të vitit 2025.

Kaka: Brazili është favorit në Botëror

Kanë mbetur vetëm pak ditë nga fillimi i Kupës së Botës. Një emër i njohur i futbollit botëror, Ricardo Kaka, ka folur për Brazilin dhe jo vetëm, duke e cilësuar mes pretendentëve. "Brazili është favorit, pasi prej kohësh punon për këtë projekt. Konfirmimi i trajnerit Tite ishte pozitiv, pasi tani grupi ka përvojën e duhur dhe mund t'i menaxhojë momentet negative. Në dy vjetët e fundit janë rritur shumë Vinicus, Rodrigo, Antony. Ka dhe të tjerë, Bremer nuk e njihja deri para pak muajsh, por është shumë i fortë. Pas Brazilit vë Argentinën dhe Francën, ndërsa si surprizë të mundshme shikoj Serbinë. Është shumë e rrezikshme", ka thënë Kaka.

Reali planifikon transferimin e Osimhenit

Real Madridi po planifikon një lëvizje me para të mëdha për yllin e Napolit, Victor Osimhen, raporton "Calciomercato". Me tetë gola në Serinë A këtë vit, Osimhen është në prag të sezonit të pestë radhazi me gola dyshifrorë. Real Madridi është i etur për ta bindur atë që të kalojë në "Santiago Bernabeu", pasi humbi Kylian Mbappen verën e kaluar. "Los Blancos" tashmë ka filluar bisedimet me përfaqësuesit e tij, por ende nuk ka diçka konkrete. Besohet se Napoli do ta linte Osimhenin të largohet vetëm për një shumë mbi 120 milionë euro, pasi ka edhe skuadra të tjera të interesuara. Chelsea, Manchester United, Manchester City dhe PSG gjithashtu i duan shërbimet e tij.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

Na osnovu člana 31 Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona br.03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova i Pravilnika br. 02/2010 o Postupku Zapošljavanja u Civilnoj Službi Kosova, u skladu sa Presudom br. Ref AGJ.1583/20 od 09. jula 2020. godine kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova KPK/br. 307/2022 od 15 februar 2022. godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova ponovno objavljuje:

KONKURS

I. Viši Referent, dve (2) radno mesto
Osnovno Tužilaštvo Priština, dve (2) pozicije

Referenca: KPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 024
Naziv Pozicije: Viši Referent
Pozicija: Pozicija od karijere
Nivo: Profesionalni
Raportira kod: Nadzornik Pisarnice
Broj Pozicija: Dve (2) pozicije
Koeficijent: Sedam (7)
Akt imenovanja: Na neodređeno
Probni rad: Dvanaest (12) meseci
Mesto: Priština

Cilj radnog mesta:

Pružna širu administrativnu i tehničku podršku u vezi primljenih predmeta u organizativnoj jedinici gde je zapošljen/a, vodi tačne i blagovremene evidencije u registru za upisanje predmeta i registru za otpisanje predmeta na osnovu specifikovanih zahteva samog registra, vođenje računa o predmetima i spisa predmeta.

Glavne Obaveze i Odgovornosti:

Blagovremeno registruje predmete u registru za prijem predmeta sa svim podacima koji se traže na osnovu registra vodeći tačne evidencije predmeta i spisa predmeta uz uvođenje elektronske evidencije;

Otpisuje predmete i vodi tačne evidencije predmeta u odgovarajućem registru i elektronskim putem, vodi evidencije o specifičnim predmetima i onih od posebne značajnosti, postupajući samo-inicijativno i bez direktnog nadzora;

Odgovoran za rokove i radne preciznosti;

Nadgleda sistem praćenja predmeta i upravlja sa predmetima na osnovu radnog opterećenja;

Kontroliše predmeta i njihovo kretanje unutar institucije, uz spremnost da u svakom trenutku obezbedi predmet za zastupanje u Sudu;

Vodi tačne i potpune evidencije u vezi dosijea i spisa predmeta, akata, ostalih službenih spisa i dokumenata, uključujući i pripremanje izveštaja o obavljenom radu u određenim izveštajnim periodima.

Spreman za obavljanje svake druge obaveze kao referent u pisarnici u skladu sa važećim zakonima i propisima;

Obavlja i ostale poslove u vezi sa radom referenta koje se mogu povremeno razumno zahtevati.

Znanje, veštine, sposobnosti za radno mesto:

Dobre pismene i usmene komunikativne veštine;

Sposobnosti za uređivanje i pažljivog sačuvanja dosijea i spisa predmeta;

Sposobnost da radi samostalno i u timskom radu;

Dobre sposobnosti rada kompjuterom (Word i Excel).

Stručna sprema i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma, Pravni Fakultet, Javna Uprava, Društvene Nauke.

Radno Iskustvo:

Najmanje dve (2) godine profesionalnog radnog iskustva.

I. Pravni Službenik 2, (5) radne mesta

Osnovno Tužilaštvo Priština, cetri (4) pozicije

Osnovno Tužilaštvo Đakovica, jedna (1) pozicija

Referenca: KPK/SKPK/ZKPSH/PA/PSRK/PTH/POZ- 025
Naziv Pozicije: Pravni Službenik 2
Pozicija: Pozicija od karijere
Nivo: Profesionalni
Raportira kod: Administrator Tužilaštvo
Broj Pozicija: Pet (5) pozicije
Koeficijenti: Sedam (7)
Akt imenovanja: Na neodređeno
Probni rad: Dvanaest (12) meseci
Mesto: Priština, Đakovica

Cilj radnog mesta:

Preduzima sve konkretne radnje i profesionalne inicijative za obavljanje efektivnijeg i kvalitativnijeg poslova Tužilaca, pružajući pravnu stručnu podršku uz izradu akata, spisa i njihovom daktilografiranju, kao i vodi evidencije o predmeta koji su u prostupku i koji su završeni od strane tužioca u saradnji sa Nadzornikom Pisarnice Tužilaštva i Rukovodiocem Administracije.

Glavne obaveze i odgovornosti:

Pomaže na profesionalan način Tužiocu uz profesionalno daktilografiranje akata koje iznese tužilac u vezi konkretnih poverenih predmeta za preduzimanje optužnih radnji od strane tužilaca;

Prima predmete koji su dodeljeni za tužioca sa kojim radi, njihovo elektronsko evidentiranje, dostavljanje predmeta uz pratećih spisa u pisarnici, vođenje evidencije za predmete koji su postupku i o završenim predmetima, izveštava o svom radu Rukovodioca Administracije/Administratora;

Učestvuje u procesu saslušanja stranaka vodeći zapisnik ispitivanja, sačuva konfidencijalnost predmeta i stranaka;

Obavlja sve pripremne poslove za prisustvo stranaka pred tužiocem uz slanjem pozivnice i primanjem potvrde od dostavljača dopisa;

Uvek se pobrine za informisanje Tužioca u vezi njegovog prisustva na suđenja, ne zanemarujući informisanje u vezi različitih spisa ili (corpora delikti) koji se nadovezuju sa predmetom;

Odgovoran za obavljanje poslova na stručan način, pobrineći se da tokom posla koji mu je poveren ima što manje propusta;

O svom radu odgovara Rukovodiocu Administracije, a za obavljeni rad sa tužiocem u vezi sa predmetima vodi odgovornost i kod tužioca predmeta, stoga se zahteva posebna pažnja i trezvenost;

Obavezan da poštuje Kod Profesionalne Etike pomoćnog osoblja i kod o civilnoj službi; Obavlja i ostale poslove koje su vezane sa njegovom pozicijom, zamenjući ostale kolege na poslu.

Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Odlučna sveobuhvatna stručna znanja iz Javne Upravne Pravne oblasti;

Dobro poznavanje albanskog, i/ ili srpskog je poželjno, u pismenom i usmenom izražavanju, uključujući razvijene sposobnosti u izradi dokumenata

Znanja sa dobrim kompjuterskim radnim sposobnostima uz aplikacije programa (Microsoft Word, Excel);

Stručna Sprema i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma, Pravni Fakultet.

Radno Iskustvo:

Jedna (1) godina profesionalnog radnog iskustva.

- Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od 10.11.2022 do 24.11.2022 kao datum isteka konkursa.
- Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, VII sprat, Kancelarija br. 702, Priština, Kosovo.
- Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, br. 100 Sprat 7, kancelarija br. 702, 10000 Priština.
- Aplikacije poslate putem pošte, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- U slučaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038 / 200 18874 od 08:00 do 16:00 časova.
- Uslovi učešća na konkursu: Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju. Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i dočekuje aplikacije od svojih osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu. "Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne državne administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova".
- Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:
 - Svedočanstvo školske spreme;
 - Dokaz o radnom iskustvu; Potvrda i radni ugovor (Referentno pismo ili preporuka se ne prihvataju kao dokaz radnog iskustva).
 - Dve preporuke (ako imate);
 - Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
 - Dokument identifikacije-fotokopirana lična karta;
 - Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjua, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavešteni na osnovu važećeg zakonodavstva.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpunesheite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Hope Boutique" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811884502 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Hope Boutique" D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811884502 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Hope Boutique" L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 811884502 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Ballkan Petrol" Sh.p.kGërlicë, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Suhadoll, Graçanicë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 07.12.2022 në ora 10:00 në hapësirat e hotel "Venus" GSM: 42°33'36.7"N 21°07'47.1"E, Graçanicë do të organizohet debat publik nga Kompania "Ballkan Petrol" Sh.p.kGërlicë, Ferizaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Suhadoll, Graçanicë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://zoom.us/j/95732444032?pwd=L3RiQWlzdWoxb01VMnVuMDErcWVwQT09>
ID: 95732444032

Meeting passcode: 53JWGi

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Ballkan Petrol" Sh.p.kGërlicë, Ferizaj për stacionin e karburanteve në Suhadoll, Graçanicë.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

